

Njoftim për Media

INSTAT binjakëzohet me Zyrën Qendrore të Statistikave të Irlandës, (CSO).

Tiranë, 07 Korrik 2015: Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe Zyra qendrore e Statistikave të Irlandës (CSO) nënshkruan marrëveshjen e binjakëzimit më datë 17 Qershor 2015, gjatë zhvillimit të Konferencës së Statisticienëve Evropianë (CES) në Gjenevë me prezencën e Zv/Drejtorit të Përgjithshëm të Eurostat znj. Mariana Kotzeva. Kjo marrëveshje u firmos nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT, Z. Gjergji Filipi dhe nga Drejtori i Përgjithshëm i CSO, Z. Pádraig Dalton.

Firmosja e kësaj marrëveshje përbën një hap të rëndësishëm në përmbushjen e angazhimit të Qeverisë Shqiptare të përcaktuar në programin e saj për binjakëzimin e Institutit të Statistikave me një institut të ngjashëm të një vendi anëtar të BE-së.

Binjakëzimi i dy institucioneve statistikore bëhet në kuadër të bashkëpunimit statistikor dhe përmirësimit të prodhimit të statistikave sipas standardeve Evropiane.

Procesi i formalizimit të bashkëpunimit midis INSTAT– CSO/Irlandë është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Statistikave Evropiane – Eurostat.

Në fazën aktuale kjo Marrëveshje do të shërbejë si një protokoll bashkëpunimi në terma të përgjithshëm, kryesisht për një orientim strategjik të institucionit drejt përmbushjes së standardeve evropiane duke konsoliduar më pas terrenin për zhvillimin dhe intensifikimin e bashkëpunimit në forma të tjera të ndihmës dhe shkëmbimit të eksperiencave. Marrëveshja do të ofrojë një garanci për statistikatat shqiptare për tu përafuar me ato evropiane.

Ky binjakëzim midis dy institucioneve, nuk do të shërbejë vetëm INSTAT, por ngritjes së kapaciteteve bashkëpunuese në të gjithë sistemin kombëtar statistikor duke bërë që Shqipëria të bëhet pjesë e Sistemit Statistikor Evropian me standardet e kërkuara nga BE.

Bashkëpunimi i ngushtë me Institutin e Statistikave të Irlandës do të jetë jo vetëm një angazhim institucional për shkëmbimin e eksperiencave por dhe një certifikatë për statistikatat shqiptare në arritjen e standardeve evropiane.